

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL**

**KOLEGJI I APELIT TË AKP-së**

**ŽALBENO VEÇE KAI**

**Lënda nr. GSK-KPA-A-63/12**

**Prishtinë, 17 janar 2013**

**Në çështjen juridike të:**

**E.H.**

Viti

*Pala ankuese*

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Filcheva – Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Anëtar, duke vendosur me ankesën e E.H., të datës 14 maj 2012, në përputhje me nenin 13.3, nenin 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 dhe nenin 196 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, pas shqyrtimit të mbajtur me 17 janar 2013, morri këtë:

## **AKTGJYKIM**

- 1- Hedhet poshtë si e palejueshme ankesa e E. H.e datës 14 maj 2012.
  
- 3- Pala ankuese obligohet që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 60 € (€ gjashtëdhjetë) brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e dorëzimit së këtij aktvendimi nën kërcënimin e përmbartimit të detyrueshëm.

### **Përmbledhja e çështjeve faktike dhe procedurale:**

Më 14 maj 2012, pala ankuese, znj. E. H. ka paraqitur ankesë kundër, siç formulohet në dokument, “vendimit të AKP-së në lidhje me pronën e saj”. Ajo i referohet një vendimit të KÇPB - HPCC/D/93/2003 të datës 17 tetor 2003 dhe një vendimit tjetër të KÇPB-së, më saktësisht vendimit HPCC/REG/95/2007 (me të cilin është refuzuar kërkesa për rishqyrtim të vendimit të parë - HPCC/D/93/2003). Ajo po ashtu ankohet kundër një letre, të datës 3 mars 2008, të nënshkruar nga Zëvendës drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kosovare të Pronës.

### **Arsyetim ligjor:**

Vendimet e lartpërmendura janë nxjerrë sipas Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 (këtej e tutje Rregullorja). Më vendimin HPCC/REG/95/2007 është refuzuar kërkesa e paraqitur nga pala ankuese për rishqyrtim kundër vendimit HPCC/D/93/2003. Dispozitat e Rregullores nuk parashohin ndonjë mjet juridik (ankesa apo mjete të jashtëzakonshme juridike) kundër vendimeve të plotfuqishëm të Komisionit për Çështje Pronësore Banësore – argumenti sipas neneve 22 dhe 23 *po aty*. Në këtë aspekt kjo gjithashtu është jurisprudencë e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës – shih Lëndën nr. KI104/10, para 64, 74 dhe 75).

Prandaj, ankesa në fjalë, e paraqitur kundër një vendimi të plotfuqishëm është e palejueshme dhe duhet të hedhet poshtë.

### **Shpenzimet e procedurës:**

Siç parashihet me Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK, 3 tetor 1987) dhe sipas UA nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore, taksa e gjyqësore si në vijim aplikohet në procedurën e tanishme të apelit:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për nxjerrjen e aktgjykimit: € 30. Kjo shumë është përlogaritur në pajtueshmëri me Nenin 10.21 (për sa i takon shpenzimeve, të paguara për nxjerrjen e vendimit për ankesën), 10.15 (për sa i takon shpenzimeve, të paguara në rast të refuzimit të padisë) dhe 10.1 (përshkrimi i rregullave të përgjithshme për përlogaritjen e shpenzimeve) të UA 2008/2.

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga pala ankuese brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e dorëzimit të këtij aktvendimi. Neni 47 paragrafi 3 parasheh së në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, pala duhet të paguajë një gjobë prej 50% të shumës së taksës. Nëse pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë atëherë bëhet zbatimi i detyrueshëm i pagesës.

### **Këshillë juridike**

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

*Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit,*

*EULEX Sylejman Nuredini, Gjyqtar*

*Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it*

*Urs Nufër, Referent i EULEX-it*